

VENDIM
Nr. 26, datë 22.2.2024

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2024 PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 579/3 prot., datë 20.2.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 643 prot., datë 1.2.2024, protokolluar me tonën me nr. 579 prot., datë 5.2.2024, përcolli në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të muajit janar 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Referuar aplikimit të sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a., për muajin janar 2024 e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- ERE, me shkresën nr. 579/1 prot., datë 16.2.2024, i ka kërkuar shoqërisë FSHU sh.a. të paraqesë profilet e blerjes në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX sh.a. për sasinë e energjisë elektrike të siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit, si dhe përlllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike duke u bazuar në këto profile.

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën nr. 1002/1 prot., datë 19.2.2024, protokolluar me tonën me nr. 579/2 prot., datë 19.2.2024, ka përcjellë aplikimin e korrigjuar sipas kërkesave të paraqitura nga ERE.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, i cili la në fuqi vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike vijojnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Kursi zyrtar i këmbimit i publikuar nga Banka e Shqipërisë lekë/euro, i cili për përlllogaritjet e muajit janar 2024 konsiderohet ai i datës 31.1.2024.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes

së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2024, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin janar 2024

		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	10.04
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.30
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	13.80

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *13.80 lekë/kWh për muajin janar 2024*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin janar 2024 prej 13.80 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi